



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 58**

Datë: 31. 10. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP; Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

---

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.57/2017*

#### **2. Shpallja e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të 22 Tetorit 2017, për Kryetar të Komunave**

#### **3. Të ndryshme**

---

#### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.57/2017*

**Valdete Daka:** Mirë se erdhët në mbledhjen nr. 58 të KQZ-së. A ka ndokush propozim, të ndryshme për këtë mbledhje...? Sot, siç jeni të njoftuar, do të bëjmë shpalljen e rezultateve për Kryetar Komune nga zgjedhjet e 22 tetorit, 2017.

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan agjendën e kësaj mbledhje.*

**Valdete Daka:** E kemi procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së nr.57/2017. A keni vërejtje...? Nëse jo, kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë procesverbal.*

## **2. Shpallja e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të 22 Tetorit 2017, për Kryetar të Komunave**

**Valdete Daka:** Ju njoftoj se, pasi që kemi pranuar konfirmimet e PZAP-së, si dhe të Gjykatës Supreme se nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe ndonjë ankesë i shpallim rezultatet e raundit të parë të Zgjedhjeve Lokale 2017 për Kryetar Komune.

Numri i qytetarëve me të drejtë vote në këtë raund, është 1 milion e 353 mijë e 613 votues, ndërsa numri i Qendrave të Votimit është 614, me gjithsej 1 mijë e 777 Vendvotime.

Siç e dini, raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetarë Komune do të zhvillohet më 19 nëntor 2017. Në raundin e dytë, shkojnë 19 komuna: Gjakova, Gjilaj, Dragashi, Istogu, Kaçaniku, Klina, Kamenica, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Rahoveci, Podujeva, Prishtina, Prizreni, Shtimja, Suhareka, Ferizaj, Vushtrria, Malishëva dhe Klokoti. Nga ky moment i shpalljes, subjektet politike dhe kandidatët e tyre për Kryetar Komune, kanë mundësi që ankesat e tyre t'i paraqasin në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në afat brenda 24 orësh.

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të 22 Tetorit 2017, për Kryetar Komune*

Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave nga këto zgjedhje, janë të publikuara në ueb faqen e KQZ-së: <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/373>

### **Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----

